

# PROGRAMI I REFORMAVE EKONOMIKE (ERP) 2024-2026

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

15 Dhjetor 2023

# PSE ËSHTË ERP I RËNDËSISHËM?

- Që nga viti 2015, të gjitha vendet kandidate për në BE dhe kandidatët potencialë përgatisin dokumentin “Programet e Reformës Ekonomike” (ERP) të cilat synojnë të:
  - (a) përgatisin vendet për pjesëmarrjen e tyre të ardhshme në procedurat e koordinimit të politikave ekonomike të BE-së;
  - (b) luajnë një rol kyç në përmirësimin e planifikimit të politikave ekonomike dhe drejtimin e reformave për të mbështetur stabilitetin makroekonomik;
  - (c) nxisin konkurrencën;
  - (d) përmirësojnë kushtet për rritje gjithëpërfshirëse dhe krijimin e vendeve të punës;
- ERP rishikohen në instancat më të larta të BE-së dhe diskutohen në takimin për “*Dialogun Ekonomik dhe Financiar vjetor midis BE-së dhe Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë.*”
- Pasi dakortësohet, dokumenti i ERP shërben si udhërrëfyes për qeveritë për prioritizimin dhe zbatimin e reformave të nevojshme ekonomike.


# PSE ËSHTË ERP I RËNDËSISHËM?

- ERP është para së gjithash një "*ushtrim trajnimi*" për të rritur kapacitetet institucionale të vendit.
- Reformat duhet të kostohen dhe buxhetohen në mënyrë që të mund të përfshihen në ERP
- Dokumenti përmban 4 kapituj:
  - *Zbatimi i Udhëzimeve Politike*
  - *Kuadri Makroekonomik*
  - *Kuadri Fiskal*
  - *Prioritete të Reformave Strukturore*
- Miratohet çdo vit nga Këshilli i Ministrave dhe i dërgohet Komisionit Evropian


# PSE ËSHTË ERP I RËNDËSISHËM?

- Duke filluar nga ky vit, ERP do shërbejë si dokumenti thelbësor për kushtëzimin e Planit të Ri të Rritjes!
  - Një fond prej **6 miliardë € për Ballkanin Perëndimor**, në formë granti dhe kredi, për t'u investuar në projekte që lehtësojnë konvergencën e standardeve ekonomike të rajonit;
  - Fondi indikativ për **Shqipërinë është thujse 1 miliardë €**;
  - Disbursimi i fondeve është i kushtëzuar nga plotësimi i reformave strukturore, një pjesë e të cilave gjenden në ERP!

# AFATI KOHOR



# CIKLI ERP 2024-2026



# ERP 2024-2026

- ERP 2024-2026 përmban disa përditësime dhe rishikime
- Tre grupime tematike, në vend të disa fushave sikundër në ERP e mëparshme:
  1. Burimet njerëzore dhe Politikat sociale;
  2. Qëndrueshmëria dhe Rimëkëmbja;
  3. Konkurrueshmëria.
- Reduktimi i numrit të reformave strukturore, nga 15-20 në 6, dhe deri në dy reforma për grup;
- Rritja e rëndësisë së dialogut me partnerët ndërkombëtarë në veçanti IFI, me më shumë fokus në plotësimin e zbatimit të reformave.

# ERP 2024-2026

Reformat strukturore të propozuara në draftin aktual ERP 2024-2026

## **Kapitali njerëzor dhe politikat sociale**

- SR #1 Edukimi dhe aftësitë
- SR #2 Hyrja në mbrojtje sociale dhe kujdes shëndetësor, dhe rritja e punësimit për grupet vulnerabël

## **Qëndrueshmëria dhe Rimëkëmbja**

- SR #3 Energjia e rinovueshme dhe tranzicioni i gjelbër
- SR #4 Transformimi digjital dhe infrastruktura

## **Konkurrueshmëria**

- SR #5 Kërkim dhe inovacioni, integrimi ekonomik dhe përmirësimi i shërbimeve
- SR #6 Përmirësimi i klimës së biznesit për SME-të dhe bizneset “start-up”



# BURIMET NJERËZORE DHE POLITIKAT SOCIALE

**SR #1 Edukimi dhe Aftësitë**

**SR #2 Aksesi në mbrojtje  
sociale dhe kujdes  
shëndetësor, dhe rritje të  
punësimit për grupet  
vulnerabël**



## Masa e Reformës 1.1: Rritja e cilësisë dhe aksesit në VET

Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe e Aftësive 2023-2030 është dokumenti kryesor i politikave që drejton zbatimin e veprimeve që lidhen me punësimin dhe zhvillimin e aftësive në vend.

### Masat kryesore që ajo parashikon janë:

- 1) *Zhvillimi i sistemit përkatës, fleksibël, absorbues dhe i bazuar në fakte të VET;*
- 2) *Forcimi sigurimit të cilësisë dhe kuadri i zhvillimit në VET;*
- 3) *Angazhimi sistemik dhe sistematik i sektorit privat në VET;*
- 4) *Nxitja e mundësive gjithëpërfshirëse të të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë;*
- 5) *Njohja e të mësuarit të mëparshëm joformal dhe spontan;*
- 6) *Digjitalizimi i shërbimeve të punësimit dhe ofrimit të VET;*
- 7) *Krijimi i sistemit të inteligjencës së aftësive që jep sinjale të rregullta për zhvillimet e tregut të punës dhe VET.*

## Masa e Reformës 1.2: Zhvillimi dhe fuqizimi i kompetencës digjitale të mësuesve

- Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka planifikuar **hartimin dhe zbatimin e programeve të TIK-ut** për të tretin vit radhazi duke filluar nga klasa I në 2022, klasa II në 2023 dhe klasa III në 2024.
- Vazhdojnë të mbeten prioritetet për të ardhmen:
  - Përmirësimi i infrastrukturës digjitale;
  - zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve dhe drejtorët e shkollave;
  - mirëmbajtja e pajisjeve etj.

## Masa e reformës 2.1:

### Përmirësimi i aksesit në programet sociale dhe të kujdesit shëndetësor

Qëllimi i përgjithshëm i masës është të zgjerojë mbulimin, gjithëpërfshirjen, efektivitetin dhe targetimin më të mirë të njerëzve në nevojë, përmes punësimit dhe shërbimeve sociale dhe kujdesit shëndetësor.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet:

- i) zhvillimit të modelit të ri të shërbimeve sociale të integruara;
- ii) vazhdimit të zbatimit të planit kombëtar të veprimit për deinstitutionalizimin;
- iii) finalizimi dhe zbatimi i kuadrit ligjor të metodologjisë në lidhje me vlerësimin dhe alokimin e Fondit Social Kombëtar;
- iv) rritja e punësueshmërisë së grupeve vulnerabël, veçanërisht nga skema e NE;
- v) fuqizimi i kapaciteteve të pushtetit vendor në referimin dhe menaxhimin e çështjes nëpërmjet sistemit elektronik dhe në procedurat e prokurimit për shërbimet e kujdesit social.

## Masa e reformës 2.2:

### Rritja e punësimit të punëkërkuessve të papunë më të rrezikuar

- Programet e nxitjes së punësimit që mbështesin grupet më vulnerabël janë zbatuar në vazhdimësi.
- Programet përfshijnë trajnimin në vendin e punës, subvencionimin e pagave, programin e praktikës, programin e vetëpunësimit dhe punësimin në komunitet.
- Është hartuar një program i ri për riintegrimin e grupeve më vulnerabël me mbështetjen e OJF-ve dhe është në konsultim me ministritë e linjës.
- Një program i ri për praktikën që do të zbatohet në kuadër të Garancisë për Rininë.
- Faza pilot do të realizohet në vitet 2023-2024 dhe do të zhvillohet në tre qarqe: Tiranë, Shkodër dhe Vlorë.

# ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE AFTËSIA PËR RIMËKËMBJE

**SR #3 Energjitë e rinovueshme  
dhe tranzicioni i gjelbër**

**SR #4 Transformimi digjital  
dhe infrastruktura**



## Masa e reformës 3.1:

### Promovimi i energjisë së rinovueshme dhe reduktimi i emetimeve të karbonit

Nëse vendet e Ballkanit Perëndimor do të ndjekin të njëjtin trend si vendet e BE-së, duke çuar në uljen e ndotjes së ajrit, përmirësimin e shëndetit të njerëzve dhe uljen e kostove shëndetësore, dekarbonizimi është hapi më i rëndësishëm përpara.

Objektivi i kësaj mase është i dyfishtë:

- (i) Të kufizojë ndjeshëm përdorimin dhe emetimet e gazeve F, dhe të ofrojë stimuj për të përdorur alternativa miqësore me klimën dhe të krijojë skemën e nevojshme të licencimit;
- (ii) Të zhvillojë sektorin e energjisë duke rritur sigurinë energjetike dhe kapacitetin e prodhimit nëpërmjet diversifikimit, masave të efijencës së energjisë, në mënyra të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin.

## Masa e reformës 3.2: Ndërhyrjet strukturore novatore dhe inovacionet teknologjike për energjinë e rinovueshme në stacionet e pompimit të ujitjes dhe kullimit

- Ndërhyrjet inovative strukturore në sektorin e bujqësisë po fokusohen gjithnjë e më shumë në përfshirjen e teknologjive të energjisë së rinovueshme për të rritur efikasitetin dhe qëndrueshmërinë.
- Një shembull kryesor i kësaj është integrimi i paneleve diellore në sistemet e pompimit të ujitjes dhe kullimit. Duke shfrytëzuar energjinë diellore, këto sisteme mund të reduktojnë ndjeshëm varësinë nga gjeneratorët konvencionalë të energjisë elektrike ose me naftë, duke çuar në një ulje të emetimeve të gazeve serrë dhe kostove të funksionimit.
- Kjo teknologji e gjelbër siguron një furnizim të besueshëm me energji, veçanërisht në zonat e largëta ku energjia elektrike e rrjetit mund të jetë e paqëndrueshme ose e padisponueshme, dhe gjithashtu promovon përdorimin e energjisë së pastër.



## Masa e reformës 4.1: Zhvillimi i ndërlidhjes dhe infrastrukturës digjitale

- Zhvillimi i infrastrukturës broadband është bërë sot një parakusht për zhvillimin social dhe ekonomik. Infrastruktura digjitale dhe digjitalizimi është pjesë e dokumenteve strategjike rajonale përkatëse.
- Elementet kryesore për zbatimin e masës së reformës gjatë viteve në vijim janë fokusuar në këto drejtime:
  - (i) Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për infrastrukturën digjitale;*
  - (ii) Rritja e kapaciteteve për zhvillimet e infrastrukturës broadband / digjitale;*
  - (iii) Promovimi i investimeve / mbulimit me rrjete me brez të gjerë.*

## Masa e reformës 4.2: Përmirësimi i aksesit në shërbimet elektronike, rritja e aftësive digjitale të përdoruesve dhe forcimi i GovTech

### 1. Përmirësimi i aksesit në shërbimet elektronike dhe përvojës së përdoruesit

*Fokusi do të jetë riorganizimi i portalit e-Albania sipas modelit “life event” nëpërmjet një përfaqseje novatore në organizimin e shërbimeve publike, duke përdorur konceptin “life event”.*

### 2. Rritja e aftësive dhe përfshirja e përgjithshme digjitale

*Theksi do të vihet në rritjen e aftësive digjitale të qytetarëve duke krijuar laboratorë TIK të njohur si “laboratorë inteligjentë”. Këta laboratorë do të ofrojnë një mjedis mbështetës për mësimdhënien dhe të mësuarit për të ndihmuar studentët të përmirësojnë njohuritë e tyre në fushën e teknologjisë.*

### 3. Forcimi i mundësuesve kryesorë të GovTech

*Investimet dhe përmirësimet e propozuara do të sjellin shumë përfitime për përdoruesit e platformës e-Albania, duke përfshirë lehtësinë e përdorimit, përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe ndërveprimin më të mirë me teknologjitë e reja.*

## **Masa e reformës 4.3: Rehabilitimi i rrjetit hekurudhor shqiptar dhe ndërlidhja për një transport të qëndrueshëm.**

- Masa i referohet rehabilitimit dhe përmirësimit të linjës hekurudhore Tiranë-Durrës, përfshirë zgjerimin e një segmenti deri në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës. Puna në këtë drejtim po vazhdon aktivisht.
- Pritet që përfundimi i këtyre punimeve të sjellë shumë avantazhe për ekonominë dhe të ndihmojë në përmirësimin e sistemit të transportit.

# KONKURRUESHMËRIA

**R.S. #5 Hulumtimi dhe inovacioni,  
integrimi ekonomik dhe përmirësimi  
i shërbimeve**

**R.S. #6 Përmirësimi i klimës së  
biznesit për SME-të dhe bizneset  
fillestare**



## Masa e reformës 5.1: Thellimi i integritit ekonomik

Masa synon ndërmarrjen e disa veprimeve në periudhën e ardhshme për të thelluar integrimin ekonomik në rajon, si:

- Zbatimi i planit të veprimit për CRM,
- Barrierat jo-tarifore,
- One-stop shop (Dritarja e Vetme Unike; Sistemi Kombëtar i Tranzitit);
- Rregullat e reja të origjinës bazuar në konventën e rishikuar PEM.

## **Masa e reformës 5.2: Përmirësimi i kapaciteteve institucionale, financiare dhe njerëzore për kërkimin dhe inovacionin**

- Ndërmarrja e kësaj reforme përputhet me objektivat afatmesme të Qeverisë, siç përshkruhet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030.
- Strategjia është në harmoni dhe kontribuon në përmbushjen e Agjendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, miratuar nga qeveria shqiptare në vitin 2015.
- Përputhet me vizionin e artikuluar në Strategjinë Kombëtare për Kërkimin, Shkencën dhe Inovacionin 2023-2030, e cila parashikon që deri në vitin 2030, Shqipëria do të lehtësojë kërkimin shkencor me cilësi të lartë duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane.

## Masa e reformës 5.3: Forcimi i luftës kundër informalitetit

- Rritja e përpjekjeve për të luftuar informalitetin qëndron si një objektiv strategjik për Administratën Tatimore, e cila ka përmirësuar vazhdimisht operacionet e saj për të ndjekur me efektivitet këtë objektiv.
- Thelbi i kësaj nisme përmbledhet si më poshtë:
  - (I) *Reduktimi i hendekut të përputhshmërisë në lidhje me TVSH-në;*
  - (II) *Reduktimi i punës së padeklaruar, nëndeklarimi i pagave;*
  - (III) *Hetimi i pasurisë së pajustificuar;*
  - (IV) *Reduktimi i mashtrimit tatimor;*
  - (V) *Reduktimi i kostove të pajtueshmërisë dhe rritja e sigurisë tatimore si dhe besimi në administratën tatimore;*
  - (VI) *Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar nga Administrata Tatimore nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve institucionale të DPT.*

## Masa e reformës 6.1: Zhvillimi i një kuadri ligjor për të mbështetur bizneset e reja inovative

- Strategjia Kombëtare për Avancimin e Ekosistemit Start-up advokon një ndryshim në paradigmen e krijimit të vlerës në Shqipëri, duke theksuar sipërmarrjen inovative dhe rritjen e produktivitetit.
- Objektivi kryesor është të forcojë rritjen ekonomike dhe të rrisë mirëqenien e popullatës. Brenda këtij konteksti, misioni i strategjisë artikulon një synim të veçantë: krijimin e një modeli të ri ekonomik të bazuar në parimet e sipërmarrjes novatore.
- Modeli i sipërmarrjes inovative bazohet në tre shtylla:
  - I. Sipërmarrja inovative;*
  - II. Sektorët strategjikë;*
  - III. Zhvillimi Gjithëpërfshirës*



## Masë reformuese 6.2: Zhvillimi i tregtisë elektronike, promovimi i eksporteve dhe internacionalizimi, rritja e aksesit në financë.

- Implementimi aktual i Strategjisë për Zhvillimin e Investimeve në Biznes për periudhën 2021-2027, në bashkëpunim me Planin e Veprimit për ekzekutimin e saj nga viti 2021 deri në vitin 2023, shërben si bazë për hartimin e masave shtesë për të mbështetur bizneset dhe investimet.
- Miratimi i Ligjit Nr. 43/2022 më 21 prill 2022, "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme," do të hapë rrugën për përmirësimin e shërbimeve të mbështetjes në biznes. Këto shërbime synojnë të krijojnë një mjedis të përshtatshëm për tranzicionin e gjelbër të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, për të shpejtuar digjitalizimin e tyre dhe për të forcuar masat që mbështesin tregtinë elektronike.
- Krijimi i Këshillit Konsultativ për NVM, siç është parashikuar në Ligjin Nr. 43/2022, do të zgjasë spektrin dhe do të rrisë cilësinë e shërbimeve për zhvillimin e biznesit, duke kontribuar në rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

**JU FALEMINDERIT!**